

“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj@hotmail.com

RELACION TEKNIK

INVESTITOR : BASHKIA PEQIN

OBJEKTI : "RIKOSNTRUKSION DHE NDERTIM PALESTRE " SHKOLLA E MESME PAJOVE

"MUSTAFA KEMAL ATATURK "



Vendi i rikonstruksionit - Bashkia Peqin - Njësia Administrative Pajove

Objekti qe rikonstruktohet - Shkolla e mesme "Mustafa Kemail Alturk ",

TE DHENA MBI OBJEKTIN EGZISTUES :

Objekti shkolla Shkolla e mesme "Mustafa Kemail Alturk ", shkolle ne ciklin arsimor te mesem.

Siperfaqe totale ndertimore e objektit – 1268 m²

Objekti shkolla Shkolla e mesme "Mustafa Kemail Alturk " eshte nje objekt egzistues 2 kate

Konstruksioni i shkolles eshte me sistem muresh mbajtese me tulla te plota 25 cm.

“Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj@hotmail.com

Rreth 435 nxënës të shkollës së Njësisë Administrative Pajove , të Peqinit, u duhet të mësojnë çdo ditë në mes të lagështirës.

Kjo godinë nuk ka pasur asnjë lloj ndërhyrjeje dhe në ditë me reshje i gjithë shiu depërton brenda.

PLANVENDOSJA EKZISTUESE ME OBJEKTIN EKZISTUES

Me poshte po paraqesim skemen e zonimit te Shkolles se mesme “Mustafa Kemal Ataturk “:



Gjendja ekzistuese e shkolles ne Pajove eshte ne gjendje teknike jo te favorshme per zhvillimin normal te mesimdhenies ne keto ambiente.

Kushtet higjenike ne shkolle dhe tualetet jane ne gjendje qe kerkojne nderhyrje emergjente.

Duke u nisur nga te gjitha problematikat qe kjo shkolle ka, rikonstruksioni eshte nje domosdoshmeri.

Me poshte po pasqyrojme te gjitha nderhyrjet qe perfshijne kete rikonstruksion.

“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj@hotmail.com

Gjendja e objektit te pershkruar me lart sot eshte e amortizuar ne te dy katet e tij.

Ne gjithe objektin do te behen nderhyrje te rrjetit elektrik ,hidraulik,perjashtuar rastet qe kane lidhje me linjat kryesore te rrjeteve te cilat mund te kerkojne permiresim.

Vihet re si ne hapsirat e brendeshme, ashtu dhe ne fasade, si ne rrjetin e furnizimit dhe te shkarkimit te ujrave, ashtu dhe ne rrjetin elektrik, rrjetin hidraulik, rrjetin e ujesjellsit dhe rrjetin e kanalizimeve, rrjetin e ngrohje - ftohjes, mungon sistemi i integruar i mkz-se, etj. Si dhe shtimin e Rrjeti i telefonise dhe IT eshte i amortizuar.

Suvatimet ne ambientet e ketij objekti, si murale ashtu dhe ato tavanore, jane te amortizuara.

Kemi nje amortizim te shtresave ne te gjithe katet e ketij objekti.

Ne kete kat ka nje prezence teper te larte te lageshtise.

Nyjet h/sanitare ne kate jane te amortizuara. Shtresat e pllakave ne klasa jane teper te amortizuara dhe kerkohet heqja e tyre.

Do te ishte zgjidhje efektive dhe estetike zevendesimi i tyre me pllaka gres-porcelan.

Ne katin perdhe per vete kushtet teknike kerkohet riorganizim i saj.

Te amortizuara jane dhe dyert e kateve perdhe, te pare .

Aktualisht gjendja fizike, nga ana tekniko-ndertimore e kesaj godine, konsiderohet mesatare.

Vendosja e saj eshte ndrmjet kuotave 60- 62 te terenit ne nje gjatesi prej afersisht 85 m ne drejtim lindje perendim 75 m .

Programi per ndertimin dhe kohezgjatjen e ketij projekti eshte parashikuar dhe eshte perpiluar nje grafik punimesh dhe cilat parashikojne kohezgjatjen e punimeve dhe perfundimin e tyre.

Afati I parashikuar I ketij ndertimi eshte 6 muaj.

Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre Lendet e para qe do te perdoren eshte ,tulla,rere gelqere per llac te cilat jane materialet baze per rikonstruksionin e ketij objekti dhe ndertim te nje palestere .

Materialet e ndertimit te domosdoshme si lene e pare do te sigurohen prane zones se ndertimit nga subjekte te licensuara .

Te dhena per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit. (perfshire sasite e ujit te nevojshem, te energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre)

Sasia e ujit teknologjik te nevojshem do te sigurohet nga burimet egzistuese te furnizimit me uje.

Ne te njejten kohe edhe furnizimi me energji elektrike do te realizohet nga rrjeti egzistues .

Aktivitetet e tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit.

“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj @ hotmail .com

Per nje funksion normal te ketij projekti do te ndertohen ambiente shetese si dhoma e kaldajes, paletrara e re Siperfaqet e nderhyrjes

Sip. E palestres – 546 m2

Sip. Fushe futbollli – 1050m2

Sip. Piste vrapimi – 250m2

Sip. Shkolle -639.21m2

Sip. Fushe basketbolli – 610m2

Sip. Shesh rreshtimi – 560m2

Informacion per lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme per projektin.

Kopje te lejeve, autorimeve dhe licencave qe disponon zhvilluesi per projektin e propozuar:

- Demtim I suvase dhe bojës së fasadës së jashtme
- Demtim I dyshemese së kateve me disnivele të pllakave dhe formimin e zonave me lageshtire.
- Amortizim I suvase së klasave dhe ambienteve funksionale
- Mungesa e terreneve sportive sipas parametrave
- Mungese të sistemit të ngrohjes
- Demtim I tavaneve duke përfshirë suvan, lageshti të tepert dhe në disa klasa me rrezik renie.
- Demtim I tualeteve në dysheme, sistemin e furnizimit me ujë dhe në funksionalitetin e tyre.
- Pjesa e jashtme e shkolles ka disnivele të ndryshme që lejojnë formimin e pellgjeve me ujë në pjesën e oborrit dhe pjesën që përdoret për aktivitete sportive.
- Demtime të konsiderueshme në rrjetin e kanalizimeve dhe lokalizimin e ujrave të shiut.

DETYRA DHE KERKESAT E PROJEKTIMIT

Rikonstruksioni i plote i ambienteve të Shkolles Pajove shkolle egzistuese me 2 kate.

Rikonstruksioni teresor i nyjeve higjenesanitare

Sistemimi i oborrit

Sistemimi i terreneve sportive

Rikonstruksioni i plote i hyrjes

Shtimi i mjediseve të sherbimit

Sherbimi i sigurimit të shkolles

Ndertimi i objektit të palestres

Nisur nga problemet e mesiperme eshte vendosur te kryhet nje projekt qe perfshin:

- Sipas situates aktuale ne pjesen e brendshme te shkolles eshte bere nje rikonstrukcion te plote i te gjitha ambjenteve lidhur se pari me riorganizimin e klasave, rrjetit te jashtem dhe sistemimin e oborrit se bashku me hapsirate reja sportive.

- Riorganizim I katit perdhe perfshin shtimin e infermerise dhe te objektit te ri te palestres sipas planimetrise se meposhteme .

Do futen ne funksion nje laborator kimie dhe biologjiedhe dhoma e infermerise se bashku me administraten e shkolles dhe klasa per mesimdhenie.

Rikonstrukcion I plote I dyshemeve te kateve duke perfshire heqjen e pllakave ekzistuese dhe veshja me hidroizolim duke shmangur problemet e lageshtise.

- Rikonstrukcion I plote I suvase se tavaneve te cdo kati .

- Shkallet do te rivishen nga e para qe nga shtresa e llacit e deri ne shtrim me pllaka mermeri duke u pajisur me korimano ne njeran ane dhe tjetren me mbeshtetese ne murin me lartesi mbi 90 cm.

- Do te shtohen shkallet e emergjences ne pjesen perendimore.

- Fasada e jashtme do te vishet me polisterol jeshil.

- Sistemim I gjithe rrjetit te ujrave te shiut me ane te zgarave te shiut, tubacioneve, ulluqeve horizontale dhe vertikale.

- Shtresa dhe veshje te pllakave ne tualeteve .

- Rrjeti I ri I sistemit te shkarkimit qe do lidhet me ate ekzistues.

- Sistemit te ri elektrik me ndricim me parametrat e duhura per secilin ambjent.

Duke pare gjendjen teper amortizuese te ngrohjes kemi mundesuar ngrohjen me kaldaje qendrore me lende djegese me gas me eficence me rendiment te larte per konsum me te vogel te energjise.

- Eshte bere gjithashtu dhe shrimi me stirio beton I dyshemese ne te dyja kateve, kjo duke bere te mundur si nivelimin dhe shmangien e humbjeve te nxehtesise duke ulur keshtu konsumimin e energjise per ngrohje.

- Dritaret jane mundesuar me profile plastike me dopio xham termik me koeficient te ulet te transmetimit te energjis, gjithashtu xhami i jashtem do te jete transparent ne menyre qe te gjithe ambjentet te marrim ndricimin maksimal.

Ne pjesen e jashtme te shkolles eshte bere nje sistemim total.

- Ne pjesen e oborrit te shkolles do te shtrohet me pllaka betoni , lulishte dhe trotuare perreth perimetrit te shkolles.

“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj @ hotmail .com

- Sitemimin e terreneve sportive ku perfshihen: fusha e futbollit; pista e vrapimit; fusha e basketbollit.
- Ne pjesen e jashtme e gjithe shkolla do rrethohet me kangjella 1.5 m larte dhe siper murit duke patur keshtu shamngie nga cdo lloj rreziku.
- Do behet rikonstruksion total I shkalleve sipas egzistuese te jashtme.
- Do behet risistemim I hapsires se gjelbert.
- Ne piken hyrese te shkolles do vendoset porta metalike me dy ndarje ku njera nga portat eshte e aksesueshme dhe nga makinat.

Sipas formes se re te rikonstruktuar objekti do te kete keto funksione ne kate:

Ne katin perdhe behet lidhja me dhomen se kaldajes per sistemin e ngrohjes .

Do ndertohet dhoma e kaldajes ne fasaden e jashtme ne pjesen jugore te shkolles .

Do futet ne funksion gjithashtu I dhoma e infermerise.

Ne katin perdhe eshte holli kryesor.

Holli kryesor i shkolles i vendosur ne hyrje te godines dhe pasohet nga korridori. Holli mendohet si nje hapësire e vetme dhe do te sherbeje jo vetem si nje vend grumbullimi e qarkullimi, por dhe si nje hapësire e lirshme ekspozimi te puneve te nxenesve duke qene se eshte i pershkrueshem gjate gjithe periudhes kohore te funksionimit te shkolles.Pjesa tjeter eshte e organizuar si klasa mesimi dhe palestra.

Ne total do jene 18 klasa per mesimdhenie + laboratore .

PLANSISTEMIMI I ZONES SE SHKOLLES



“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj @ hotmail .com

Siperfaqet e nderhyrjes

Siperfaqja e katit perdhe – 630 m²

Siperfaqja e katit te pare – 630 m² ,ne total 1260 m²

Sip. E palestres – 546 m²

Sip. Fushe futbollli – 1050m²

Sip. Piste vrapimi – 250m²

Sip. Fushe basketbolli – 610m²

Sip. Shesh rreshtimi – 560m²

Organizimi i hapsirave eshte bere ne menyre te tille qe te plotesoje te gjitha sherbimet e mundshme per nje mesimdhenie sa me efektive.

Me poshte po bashkelidhim planimetrit e shkolles per te detajuar me mire organizimin e hapsirave te saj.

Nderhyrja per riparimin e atise eshte e domosdoshme ne objekt. Projektuesi/t duhet te verifikojte gjendjen ekzistuese dhe te nderhyje ne problematikat qe ai verifikon.

Projektuesi/t duhet te jape te gjitha detajet per hidroizolimin dhe per menyren e realizimit, per vendosjen e kasetave së shkarkimit, ullukeve horizontale dhe vertikale si dhe detaje te tjera te domosdoshme për zbatimin e punimeve.

Muret

Nderhyrja ne te gjitha detajet e përforcimit te muratures mbajtese ne rastin kur ajo paraqitet me probleme.

Muret perimetral te jashtem do te trajtohen me te njejtin volum, forme, ngjyre si ato te objektit ekzistues dhe ne harmoni me te.

Ne keto raste muret perimetral te jashtem do te trajtohen me materiale termoizoluese dhe kompakesi te larte ne shtresat e jashtme te veshjes .

Suvatimet

Per suvatimet e brendshme, do te behet verifikimi i cilesise se suvatimit ekzistues ne mure dhe ne tavane. Në pjeset e demtuara, suvatimet e mureve dhe tavaneve, do te kryhen ne te gjithe siperfaqet perkatese. Të gjitha shtresat e tjera ne rast se jane te demtuara do të hiqen pa dëmtuar muret. Per xokolin do te behet propozim i ri pas pastrimit dhe hidroizolimit.

Shtresat

“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj@hotmail.com

Pllakat ekzistuese te dyshemese se bashku me llaçin e vjeter do te hiqen ne te gjithë siperfaqen. Perpara vendosjes se shtresave te reja te dyshemeve, do te behet nivelimi i dyshemese me llac-cimento, shtresa e lehtesuar (stiro beton) maskuese 4-5cm per maskimin e tubacioneve.

Ne dyshemete e banjove do te behet hidroizolimi i tyre. Duhet te gjitha kuotat e nevojshme, dhe detajet perkatese te shtrimit të pllakave, te shtresave te tjera si dhe te vendosjes se pragjeve. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartesi te caktuar para se te vishen me pllaka, duhet të hidroizolohen (vertikalisht max. 10 cm).

Dyert dhe dritaret

Duhet treguar kujdes për projektimin e dyerve dhe dritareve për te siguruar materiale rezistente për to.


Dritaret duhet te jene termoizoluese. Format e dritareve duhet ti pershtaten arkitektures dhe kerkesave funksionale te ambienteve te godines. Te projektohen me material d/plastik me dopio xham dhe gomine nga te dy anet, konfiguracioni (kompozimi) i kanatave te realizohet, njeri ½ fiks me shul vertical, ndersa kanati tjeter te realizohet me mekanizem te kombinuar qe e hap ate si vertikalisht (ne nje kend 15-30 grade) por dhe horizontalisht 90 grade.

Ngjyra e materialit te jete e njejte me ate te dritareve te tjera te fasades. Gjithashtu per katet perdhe, pajisja e tyre me elementet metalike mbrojtës perkates.


Ambientet sanitare

Banjot behen te ajrosura, te ndriçuara dhe te ventiluara. Kur s'ka ajrim direkt duhet te pajisen me impiant (aspiratore) ajrimi dhe ventilimi. Kollonat e shkarkimit behen te shkeputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim në cati dhe shkarkimet te jene te kontrollueshme. Banjot behen me porta të hapshme nga jashte dhe te shkeputura nga dyshemeja.

PLANIMETRIT E OBJEKTIT



Ne katin perdhe eshte menduar te sitemohen 4 zyra , 9 klasa per mesim dhe ambjenti per tualet eshte i ndare ne 4 wc allafrenge dhe nje wc eshte per nxenesit me aftesi te kufizuar.



Ne katin e pare eshte menduar te sitemohen 4 zyra , 9 klasa per mesim dhe ambjenti per tualet eshte i ndare ne 4 wc allafrenge, dhe nje depo e cila do te sherbej per personelin (sanitaret).

Ne pjesen jugore te godines se shkolles do te shtohet dhe objekti i palestres.

Ambientet e palestres

Ne ambjentin e palestres do kryen keto punime: ndertim me mur me tulle $t=20\text{cm}$, lartesi deri 3m , Suvatim mur I brendshem, llac, hidroizolim vertikal I mureve $h=2\text{m}$, Veshje vertikale e mureve $h=2\text{m}$, vendosja me parket druri,

Suvatim I mureve te jashtme, vendosja e dymve prej duralumini, dritare duralumini dopio xham . Lyerje me boje plastike ne muret e brendshme, Lyerje me boje plastike ne muret e jashtme.

Struktura e saj do te realizohet me konstrukcion metalik. Ndertesa e palestres do te sitemohet ne ambientin e zones sportive dhe ambientin e zonave te veshjes dhe nyjeve higjeno-sanitare perkatese.


“Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj@hotmail.com

Carjet ne fasade jane me dimensione (320x100) cm. Zona sportive ze nje hapsire prej 321 m2. Per konstruksionin e saj do te perdoren materialet beton C25/30 dhe celik S500. Soleta e kuotes +2.30 eshte projektuar te ndertohet me traveta dhe trashesi t=30cm. Si material mbushes do te perdoren tullat qeramike me brima me dimensione (40x40x25) cm.



ent
a


PLANIMETRIA E PALESTRES

“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj@hotmail.com



“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj@hotmail.com

Fasadat e objektit V- J -L -P jane si me poshte:

Pamja e orjentuar nga veriu



“ Ersi ” – shpk

Adresa Rruga Margarita Tutulani – Tirane

Mobil 0.672073098 : e - mail ersi-shpk@hotmail.com

fagoxhaj@hotmail.com

Pamja e orjentuar nga jugu



Procurement
Albania

PUNOI

"ERSI/M" shpk

Administratori

Ing. Gezim GOXHAI

